

UDHËZIM
Nr. 20, datë 17.1.2025

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR VLERËSIMIN BIOPSIKOSOCIAL TË
AFTËSISË SË KUFIZUAR TE TË RRITURIT DHE FËMIJËT DHE
METODOLOGJINË E RISHIKIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 2, të kreut III, të vendimit nr. 722, datë 11.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Miratimin e kriterëve të rishikuara të vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar te të rriturit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
2. Miratimin e kriterëve të rishikuara të vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar te fëmijët, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
3. Kriteret biopsikosociale pasqyrojnë ecurinë në mjekësinë bashkëkohore dhe plotësohen dhe/ose ndryshohen në bashkëpunim me mjekët specialist dhe në përputhje me zhvillimin shkencor, sipas edhe zhvillimeve në fushën farmakologjike në trajtimin e sëmundjeve duke ndikuar në aftësinë e kufizuar.
4. Ngarkohet Shërbimi Social Shtetëror, Komisioni Shumëdisiplinor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, strukturat e shërbimit shëndetësor parësor dhe dytësor, qendrat komunitare të shëndetit mendor dhe Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët për zbatimin e këtij udhëzimi.
5. Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Shëndetësisë dhe i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 21, datë 7.10.2016, shfuqizohet.
Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Albana Koçi